



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E MBIKËQYRJES NË FUSHËN E DREJTËSISË PENALE DHE
SIGURISË PUBLIKE

Nr. 1350/6 prot.

Tiranë, më 24.06.2026

REKOMANDIM

Nr. 32, datë 24.06.2026

PËR KONTROLLUESIN
“SHTËPIA E TË MOSHUARVE, TIRANË”

Në mbështetje të neneve 81, 82, 83 dhe 84 të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”¹ (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Shtëpia e të moshuarve, Tiranë” (në vijim, “Kontrolluesi”),

KONSTATOHET SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 110, datë 18.05.2026, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- *Zbatimi i ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e grupit të hetimit, procesverbalin e hetimit administrativ dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi është një institucion publik në varësi të Shërbimit Social Shtetëror, i cili ofron shërbime rezidenciale për të moshuarit, bazuar në vlerësimin multi-disiplinor të

¹Ligji aktual në fuqi, i cili shfuqizon ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Për këtë arsye, orientojmë të gjitha subjektet e ligjit të përditësojnë bazën ligjore në të gjitha aktet rregullatore.

nevojave të tyre. Kontrolluesi ka si mision të veprimtarisë së tij ofrimin e përkujdesit social mbi bazën e standardeve të miratuara për të moshuarit, duke përmirësuar cilësinë e jetës, nxitjen e integritetit social, si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

2. Konstatohet se Kontrolluesi, në funksion të veprimtarisë së tij dhe përmbushjes së detyrave ligjore, përpunon të dhëna personale dhe të dhëna sensitive, pjesë të dosjeve të përfituesve nga programet dhe shërbimet që ofron ky institucion.

Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen janë: “Emër”, “Mbiemër”, “Data e lindjes”, “Nr. i identifikimit”, “Gjinia”, “Vendlindja”, “Shtetësia”, “Adresa”, “Gjendja Civile”, “Foto”, “Certifikatë personale dhe familjare”, “Formimi profesional”, “Të dhëna ekonomike dhe financiare”, “Statusi familjar”, si dhe të dhënat sensitive, si “Gjendja psiko-emocionale” dhe “Gjendja shëndetësore”.

Përpunimi i të dhënave personale për kategorinë e subjekteve të të dhënave “përfitues” kryhet në mënyrë manuale, nëpërmjet një regjistri të dedikuar për regjistrimin e të dhënave të përfituesve.

3. Konstatohet se Kontrolluesi ka vënë në dispozicion të grupit të hetimit administrativ “Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale” lidhur me aktivitetin e institucionit. Në nenin 7 “Format dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale në SHMT” përcaktohet se përpunimi i të dhënave personale kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike nëpërmjet sistemeve që ka në përdorim Kontrolluesi.

Gjithashtu, në paragrafin e dytë të nenit 7 të rregullores “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale” përcaktohet se përpunimi i të dhënave personale për punonjësit kryhet nëpërmjet sistemit shtetëror të DPT, ndërsa përpunimi i të dhënave personale për operatorët ekonomikë realizohet nëpërmjet sistemit të APP.

Lidhur me këto përcaktime, nga ana e përfaqësuesve të Kontrolluesit deklarohet se ata nuk disponojnë asnjë sistem elektronik përmes të cilit të popullohen dhe përpunohen të dhëna personale.

Sa më sipër, konstatohet se Kontrolluesi, në rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, parashikon rregulla të përgjithshme dhe jo direkt të aplikueshme lidhur me proceset përpunuese që kryen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij nëpërmjet sistemeve elektronike, në kundërshtim me parashikimet e nenit 28 të Ligjit. Konkretisht, neni 7 i rregullores (“Format dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale në SHMT”) përshkruan procese përpunimi që nuk gjejnë zbatim konkret në objektin e aktivitetit të Kontrolluesit, çka vjen në kundërshtim me parashikimet e neneve 27 dhe 28 të Ligjit.

Parashikimi në aktet e brendshme të sistemeve, mekanizmave apo proceseve që në praktikë nuk janë funksionale ose nuk zbatohen, krijon një pasqyrë të pasaktë dhe jo të besueshme mbi aktivitetet e përpunimit të të dhënave personale të kryera nga Kontrolluesi. Gjithashtu, mungesa e përcaktimeve të qarta të rregullave të mësipërme është në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në nenin 28 të Ligjit.

Një situatë e tillë cenon parimin e transparencës dhe të përgjegjshmërisë në përpunimin e të dhënave personale, të parashikuara në pikat 1 dhe 7 të nenit 6 të Ligjit, si dhe bie ndesh me detyrimin e Kontrolluesit për të dokumentuar çdo veprim përpunimi të të dhënave personale, me qëllim garantimin e përputhshmërisë me kërkesat e Ligjit dhe masat teknike e organizative efektive, në përputhje me nenet 27 dhe 28 të këtij Ligji.

Për këtë arsye, Zyra e Komisionerit vlerëson se është i nevojshëm rishikimi i këtij akti, me qëllim parashikimin e rregullave dhe procedurave specifike organizative mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale sipas proceseve përkatëse, si një detyrim shumë i rëndësishëm, në zbatim të neneve 27 dhe 28 të Ligjit, për të mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Këto dispozita ligjore kërkojnë që çdo Kontrollues të përcaktojë dhe zbatojë masa të përshtatshme teknike dhe organizative, të cilat garantojnë përpunimin e të dhënave personale në mënyrë të sigurt dhe sipas parimeve të Ligjit, duke ruajtur integritetin, konfidencialitetin dhe disponueshmërinë e tyre.

4. Nga shqyrtimi i rregullores “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, si dhe nga analizimi i akteve të tjera rregullatore të vendosura në dispozicion nga Kontrolluesi, konstatohet se në asnjë dispozitë të tyre nuk janë përcaktuar afate të qarta dhe konkrete lidhur me kohën e ruajtjes së të dhënave personale. Për më tepër, nga ana e Kontrolluesit nuk është vendosur në dispozicion asnjë akt apo formë që dëshmon asgjësimin e të dhënave apo dokumentacionit të administruar gjatë veprimtarisë së tij.

Nga ana e grupit të hetimit administrativ është konstatuar se Kontrolluesi ruan dhe administron dokumentacion në arkivin e tij fizik që nga viti 1992.

Mungesa e përcaktimit të afateve konsiston në shkelje të detyrimeve të parashikuara nga Ligji, pasi përcaktimi i kohës së ruajtjes së të dhënave personale është një nga parimet thelbësore të mbrojtjes së të dhënave personale. Kjo tregon gjithashtu mungesë në zbatimin praktik të procedurave të asgjësimit të të dhënave, të cilat janë po aq të rëndësishme sa vetë ruajtja e tyre, në mënyrë që të parandalohen rreziqet e ruajtjes përtej afatit, në kundërshtim me parimin e ruajtjes në kohë, të parashikuar në pikën 5 të nenit 6 të Ligjit, i cili kërkon që të dhënat personale të ruhen vetëm për periudhën kohore që është e nevojshme për qëllimet për të cilat ato janë mbledhur dhe përpunuar.

Për sa më sipër, konstatohet se Kontrolluesi nuk ka marrë masa për përcaktimin e afateve konkrete për ruajtjen dhe shkatërrimin e të dhënave personale, duke pasur në vëmendje rëndësinë e garantimit të sigurisë së informacionit dhe mbajtjen e dokumentacionit për aq kohë sa është i nevojshëm për qëllimin për të cilin është grumbulluar, në kundërshtim me parimin e ruajtjes në kohë, sipas pikës 5 të nenit 6 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me kategoritë e të dhënave të grumbulluara, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, Kontrolluesi duhet të parashikojë mbajtjen e të dhënave personale të grumbulluara në atë formë, që lejon identifikimin për një kohë të caktuar, por jo më tepër se sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin të dhënat janë grumbulluar. Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimin e pikës 5 të nenit 6 të Ligjit. Gjithashtu, në momentin e përfundimit të qëllimit të përpunimit, Kontrolluesi duhet të realizojë shkatërrimin e këtyre të dhënave, pasi përpunimi i mëtejshëm i tyre konsiderohet i paligjshëm.

5. Konstatohet se Kontrolluesi ka të instaluar sistemin e video survejimit CCTV, i përbërë nga 9 kamera, përmes të cilit kryen mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme dhe të jashtme ku ushtron veprimtarinë e tij.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion konstatohet se, lidhur me këtë proces përpunues, Kontrolluesi nuk ka miratuar rregulla apo politika të brendshme specifike për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, nivelet e aksesit, afatet e ruajtjes së të dhënave etj., nëpërmjet sistemit të video-surveimit CCTV, në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit dhe me parashikimet e Udhëzimit nr. 3, datë 30.04.2025, të Komisionerit “Për përpunimin e të dhënave personale nga sistemet e video survejimit” (në vijim, “Udhëzimi nr. 3”).

Gjithashtu, nga verifikimet e kryera në sistemin e video-surveimit CCTV rezulton se të dhënat imazhe/video ruhen për një periudhë prej 37 ditësh, në kundërshtim me parimin e ruajtjes në kohë, sipas pikës 5 të nenit 6 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit. Në mungesë të përcaktimit të një afati ligjor lidhur me këtë proces përpunues, sipas legjislacionit specifik në bazë të të cilit ushtron veprimtarinë, Kontrolluesi duhet t’i referohet parashikimeve të Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, Kontrolluesi është i detyruar të hartojë rregulla/politika të brendshme specifike për mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, nivelet e aksesit, afatet e ruajtjes së të dhënave etj., nëpërmjet sistemit të video-surveimit CCTV, në përputhje me parashikimet e nenit 28 të Ligjit dhe me parashikimet e Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit.

Sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se Kontrolluesi mund të përpunojë të dhënat e subjekteve të të dhënave nëpërmjet sistemit të video-surveimit CCTV, për

aq kohë sa ekziston qëllimi i ligjshëm për të cilin ato janë grumbulluar. Në momentin që qëllimi ka përfunduar, Kontrolluesi duhet të realizojë shkatërrimin e të dhënave të përpunuara përmes sistemit të video-survejitimit CCTV, referuar parashikimit të pikës 5 të nenit 6 të Ligjit dhe të pikës 2 të nenit 3 të Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit.

6. Gjatë verifikimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Kontrolluesi u konstatua se ky i fundit përpunon të dhëna sensitive shëndetësore të subjekteve përfituese.

Konstatohet se dokumentet që përmbajnë të dhëna sensitive si *“Programi individual i trajtimit psikologjik për të moshuarin”*, *“Procesverbali i seancës individuale psikologjike”* dhe *“Kartelat shëndetësore”* administrohen përkatësisht nga psikologu dhe mjeku i institucionit. Administrimi dhe ruajtja e tyre bëhet duke i mbajtur të ndara nga dokumentet e tjera të cilat janë pjesë e dosjes së përfituesit, në përputhje me parashikimet e Ligjit.

Megjithatë, nga analizimi i *“Rregullores për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, grupi i hetimit administrativ konstaton se, megjithëse Kontrolluesi aplikon në praktikë ndarjen dhe trajtimin e duhur të të dhënave sensitive, ky proces nuk është parashikuar në rregullore apo akte të tjera të brendshme rregullatore, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Lidhur me sa më sipër, konstatohet se rregullorja për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale nuk përmban dispozita të posaçme që trajtojnë të dhënat sensitive që përpunohen nga Kontrolluesi, si dhe për këtë kategori të të dhënave personale nuk janë hartuar rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të tyre, administrimin, sigurinë, konfidencialitetin etj., si një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të neneve 9 dhe 28 të Ligjit, si dhe Udhëzimit nr. 2, datë 30.04.2025, të Komisionerit *“Për mbrojtjen e të dhënave personale shëndetësore”* (në vijim, *“Udhëzimi nr. 2”*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se Kontrolluesi është i detyruar të marrë masa shtesë të sigurisë së përpunimit për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe të parashikojë rregulla të veçanta për këtë kategori të të dhënave personale në rregulloren *“Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, në përputhje me nenet 9 dhe 28 të Ligjit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë të dhënave sensitive. Mungesa e rregullimit të qartë për këto kategori të dhënash përbën cenim për përpunimin e ligjshëm, të drejtë dhe transparent të të dhënave personale.

Për shkak të natyrës së tyre të ndjeshme, Kontrolluesi duhet të hartojë rregulla dhe procedura organizative specifike për këtë kategori të të dhënave personale, në lidhje me mënyrën e përpunimit dhe sigurinë e tyre, në përputhje me nenet 9 dhe 28 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 2 të Komisionerit.

Gjithashtu, Kontrolluesi duhet të marrë masa për dokumentimin e të gjitha veprimtarive të përpunimit të të dhënave personale, në formë të shkruar dhe në format elektronik, sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit, me qëllim demonstrimin e përputhshmërisë me Ligjin.

7. Konstatohet se Kontrolluesi nuk ka marrë masa në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, në kundërshtim me parashikimet e germave “c” dhe “ç” të nenit 34 të Ligjit dhe pikës 2 të nenit 5 të Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, bazuar në gerrat “c” dhe “ç” të nenit 34 të Ligjit dhe pikës 2 të nenit 5 të Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete në kuadër të pjesëmarrjes dhe organizimit të trajnimeve të dedikuara për punonjësit që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Trajnimet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale duhet të jenë të vazhdueshme dhe të përshtatura sipas nevojave dhe proceseve të punës të Kontrolluesit dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim ndërgjegjësimin e punonjësve, të cilët për shkak të proceseve të punës janë të ngarkuar për përpunimin e të dhënave personale.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar Kontrolluesit me rrugë postare.

Në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesit i është lënë afat të depozitojë pretendimet me shkrim, referuar procesverbalit të hartuar nga ana e grupit të hetimit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Kontrolluesi, përmes shkresës nr. 1350/5 prot., datë 17.06.2026, ka dërguar procesverbalin e nënshkruar nga ana e përfaqësuesit të tij dhe nuk ka paraqitur pretendime shtesë në lidhje me gjetjet e konstatuara nga grupi i hetimit administrativ.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimit të tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm, pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 6, 9, 27, 28, 34, 81, 82, 83 dhe 84 të Ligjit, Komisioneri,

REKOMANDON:

1. Kontrolluesi të ketë në vëmendje proceset e përpunimit të të dhënave personale, si dhe të marrë masa për përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave, për të gjitha proceset e përpunimit, duke përfshirë edhe ato përmes sistemit të video-survejitimit CCTV, në përputhje me pikën 5 të nenit 6 të Ligjit. Në momentin e përfundimit të qëllimit të përpunimit, Kontrolluesi duhet të realizojë shkatërrimin e këtyre të dhënave, pasi përpunimi i mëtijshëm i tyre konsiderohet i paligjshëm;
 2. Kontrolluesi, në zbatim të neneve 27 dhe 28 të Ligjit, të rishikojë rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, duke përcaktuar rregulla dhe procedura specifike, konkrete dhe direkt të aplikueshme mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale që kryen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij nëpërmjet sistemeve elektronike;
 3. Kontrolluesi të marrë masa për hartimin e rregullave dhe procedurave organizative specifike për të dhënat sensitive (të dhënat psiko-sociale dhe të dhënat e lidhura me shëndetin), në lidhje me mënyrën e përpunimit dhe sigurinë e këtyre të dhënave, si dhe të vendosë rregulla të posaçme për mbrojtjen e të dhënave sensitive të subjekteve përfituese, në përputhje me nenet 9, 27 dhe 28 të Ligjit, si dhe Udhëzimin nr. 2 të Komisionerit;
 4. Kontrolluesi të marrë masa për hartimin dhe miratimin e rregullave apo politikave, mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, nivelet e aksesit, afatet e ruajtjes së të dhënave etj., nëpërmjet sistemit të video-survejitimit CCTV, sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit;
 5. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në gjerat “c” dhe “ç” të pikës 1 të nenit 34 të Ligjit lidhur me trajnimin e nëpunësit për mbrojtjen e të dhënave, si dhe punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, në përputhje me proceset përpunuese që ata kryejnë gjatë veprimtarisë së tyre.
 6. Në zbatim të nenit 84 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:
 - i) vazhdimisht, detyrimin e treguar në pikën 4 më sipër;
 - ii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimin e treguar në pikën 1 më sipër;
 - iii) brenda 45 (dyzet e pesë) ditëve, detyrimin e treguar në pikat 2, 3 dhe 4 më sipër.
- Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;
7. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;

8. Komisioneri, bazuar në germen “a”, pika 2 e nenit 83 të Ligjit, paralajmëron kontrolluesit ose përpunuesit se veprimet e përpunimit mund të rezultojnë në mosplotësim të dispozitave ligjore dhe u jep atyre rekomandime lidhur me përputhshmërinë me ligjin. Në rast të moszbatimit të tyre, Komisioneri vepron sipas neneve 92, 93 dhe 94 të Ligjit, për vendosjen e sanksioneve administrative në përputhje me nenet përkatëse, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative, në mënyrë të tillë që këto masa të jenë efektive, proporcionale dhe me karakter parandalues.

Ky Rekomandim u shpall sot, më 24.06.2026.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi